



**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL
DHE KUALIFIKIMEVE**

Sektori i Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP

PROGRAMI I KURSIT

“MINATOR DHE ARMATOR”

(Kodi: K-I-1-14)

Tiranë, Maj 2014

PROGRAMI I KURSIT

“MINATOR DHE ARMATOR”

(K-I-1-14)

I. Profili Profesional i Minatorit dhe armatorit

a) *Karakteristikat e Minatorit dhe armatorit*

Minatori dhe armatori do të jetë i aftë të kryejë **detyra** profesionale në galeritë e minierave që kanë të bëjnë me shpimin e birave për hapjen e punimeve minerare dhe të rrëzimit të mineralit, me ndërtimin e armaturave të ndryshme dhe me kontrollin e galerisë për kushte të sigurta pune, duke punuar i organizuar në grup pune.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, minatori dhe armatori duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet bazë të vendburimeve minerare, proceset dhe organizimin e punës në miniera, rregullat e sigurisë së punës në miniera, dokumentacionin e punës në miniera, ndërtimin dhe funksionimin e mjeteve të punës në miniera etj.

Suksesi i minatorit dhe armëtarit në këtë profesion është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qendrim) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mosperdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) *Mundësitë e punësimit të Minatorit dhe armatorit dhe karriera profesionale e tij*

Profesioni i Minatorit dhe armatorit është i lidhur ngushtë me punimet në miniera. Ai mund të punësohet në kompani minerare (në nëntokë dhe sipërfaqe) në pozicione pune të tilla si minator dhe armator në punime minerare dhe në rrëzimin e mineralit.

Minatori dhe armatori mund të hyjë në profesion si ndihmës minator. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e minatorit dhe armatorit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një minator dhe armator mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në përgjegjësi të turnit apo i njësisë së shërbimit. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin inxhinier miniere.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për Minator dhe armator

Në përfundim të Kursit për Minator dhe armator, kursantët do të jenë të aftë të:

- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin e punimeve në miniera.
- Bëjnë organizimin e vogël të punës dhe mbikqyrjen e grupit që drejtojnë.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në minierë.
- Përzgjedhin mjetet dhe materialet e duhura të punës.
- Përdorin dhe mirëmbajnë mjetet dhe mjedisin e punës.
- Kryejnë punime përgatitore, matje dhe kontrolle gjatë punës në galeri.
- Përdorin dhe mirëmbajnë çekiçin shpues pneumatik.
- Kryejnë hapjen e punimeve minerare.
- Kryejnë rrëzimin e mineralit.
- Ndërtojnë armatime të ndryshme në galeri.

III. Kohëzgjatja e Kursit për Minator dhe armator

10 Kredite = 300 orë mësimore, ku

1 Kredit = 30 orë mësimore dhe

1 orë mësimore = 45 minuta

IV. Kërkesat e pranimit në Kursin për Minator dhe armator.

Pjesëmarrësit në Kursin për Minator dhe armator duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të kenë përvojë pune si ndihmës në minierë.

V. Modulet e Kursit për Minator dhe armator.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në punimet minerare	MK-15-001-14	1 Kredit (30 orë) Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti tregon veçoritë e profesionit të minatorit dhe armatorit. 2. Kursanti përshkruan konceptet bazë që lidhen me vendburimet minerare. 3. Kursanti përshkruan llojet e punimeve minerare. 4. Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës në front.
2	Sigurimi teknik në minierë	MK-15-002-14	0.5 Kredite (15 orë) Rekomandohet: 70% Teori 15% Praktikë 15% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan parimet e përgjithshme të sigurimit teknik në minierë. 2. Kursanti përshkruan masat e sigurimit teknik në minierat nëntoksore. 3. Kursanti përshkruan masat e sigurimit teknik në minierat sipërfaqësore. 4. Kursanti përshkruan rregullat për ruajtjen e mjedisit në miniera
3	Punime përgatitore dhe të kontrollit në galeri.	MK-15-003-14	0.5 Kredite (15 orë) Rekomandohet: 20% Teori 65% Praktikë 15% Vlerësime	1. Kursanti bën organizimin e vogël për punën në galeri 2. Kursanti kryen kontrolle në galeri.
4	Përdorimi dhe mirëmbajtja e çekiçit shpues pneumatik.	MK-15-004-14	2 Kredite (60 orë) Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e çekiçit shpues pneumatik 2. Kursanti përdor çekiçin shpues pneumatik 3. Kursanti mirëmban dhe riparon çekiçin shpues pneumatik.
5	Hapja e punimeve minerare.	MK-15-005-14	2 Kredite (60 orë) Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan procesin e hapjes së punimeve minerare. 2. Kursanti kryen shpimin e birave për avancim.

6	Rrëzimi i mineralit	MK-15-006-14	1 Kredit (30 orë) Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan procesin e rrëzimit të mineralit. 2. Kursanti kryen rrëzimin e mineralit.
7	Punimet e armatimit në minierë.	MK-15-007-14	3 Kredite (90 orë) Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan punimet e armatimit në miniera. 2. Kursanti ndërton armatura prej druri 3. Kursanti ndërton armatura metalike 4. Kursanti ndërton armatura betoni 5. Kursanti ndërton armatura të kombinuara

VII. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantet vlerësohen nga instruktoret e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, marrin Çertifikatën nga autoriteti përkatës.

VIII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Minator dhe Armator.

1. Moduli “Hyrje në punimet minerare”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PUNIMET MINERARE	(MK-15-001-14)
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e punimeve minerare dhe me konceptet e parimet bazë ku mbështetet puna në miniera	
Kohëzgjatja e modulit	1 Kredit 30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të kenë punuar si ndihmës në minierë.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti tregon veçoritë e profesionit të minatorit dhe armatorit. Përmbajtja: - Detyrat dhe punimet kryesore të minatorit dhe armatorit. - Mundësitë e punësimit të minatorit dhe armatorit. - Mjedisi dhe kushtet e punës së minatorit dhe armatorit. - Organizimi i punës në minierë. - Kërkesat profesionale për minatorin dhe armatorin. - Karriera profesionale e minatorit dhe armatorit.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë detyrat dhe punimet kryesore të minatorit dhe armatorit.
- të tregojë mundësitë e punësimit të minatorit dhe armatorit.
- të përshkruajë mjedisin dhe kushtet e punës së minatorit dhe armatorit.
- të analizojë organizimin e punës në minierë.
- të tregojë kërkesat profesionale për minatorin dhe armatorin.
- të shpjegojë karrierën profesionale të minatorit dhe armatorit.

RM 2 Kursanti përshkruan konceptet bazë që lidhen me vendburimet minerare.

Përmbajtja:

- Konceptet bazë të gjeologjisë së përgjithshme.
- Vendburimet minerare në Shqipëri.
- Rezervat e mineralit të dobishëm dhe klasifikimi i tyre.
- Vendburimet minerare dhe mënyrat e hapjes së tyre.
- Përgatitja e trupave për shfrytëzim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë konceptet bazë të gjeologjisë së përgjithshme.
- të tregojë vendburimet minerare në Shqipëri.
- të përshkruajë rezervat e mineralit të dobishëm
- të bëjë klasifikimin e mineraleve të dobishme.
- të tregojë vendburimet minerare dhe mënyrat e hapjes së tyre.
- të përshkruajë përgatitjen e trupave për shfrytëzim.

RM 3 Kursanti përshkruan llojet e punimeve minerare.

Përmbajtja:

- Klasifikimi dhe vetitë e shkëmbinjve.
- Bazat e mekanikës së shkëmbit.
- Llojet e punimeve minerare.
- Punimet minerare horizontale dhe veçoritë e tyre.
- Punimet minerare të pjerrëta dhe veçoritë e tyre.
- Punimet minerare vertikale dhe veçoritë e tyre.
- Proceset kryesore të punës në minierë.
- Llojet e armaturave dhe veçoritë e tyre.
- Pasaportat e shpim-plasjes në llojet e ndryshme të punimeve minerare.
- Transporti në llojet e ndryshme të punimeve minerare.

- Makineritë kryesore që përdoren në minierë.
- Ajrimi në punimet minerare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të bëjë klasifikimin e shkëmbinjve.
- dhe përshkruajë vetitë e shkëmbinjve.
- të përshkruajë bazat e mekanikës së shkëmbit.
- të tregojë cilat janë llojet e punimeve minerare.
- të analizojë punimet minerare horizontale, të pjerrëta dhe vertikale dhe të tregojë veçoritë e tyre.
- të përshkruajë proceset kryesore të punës në minierë.
- të tregojë llojet e armaturave dhe veçoritë e tyre.
- të interpretojë pasaportat e shpim-plasjes në llojet e ndryshme të punimeve minerare.
- të përshkruajë transportin në llojet e ndryshme të punimeve minerare.
- të dallojë makineritë kryesore që përdoren në minierë.
- të përshkruajë procesin e ajrimit në punimet minerare.

RM 4 Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës në front.

Përmbajtja:

- Mjedisi dhe kushtet e punës në minierë.
- Veglat e punës së dorës së minatorit dhe armatorit.
- Pajisjet mbrojtëse individuale të minatorit dhe armatorit.
- Pajisjet ngarkuese dhe transportuese në galeri.
- Pajisjet për shpimin e lagur.
- Pajisjet për prodhimin dhe shpërndarjen e ajrit të ngjeshur.
- Pajisjet e kontrollit të mjedisit në minierë.
- Materialet plasëse, klasifikimi dhe përdorimet.
- Materialet për armaturat, klasifikimi dhe përdorimet.
- Kujdesi për mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë mjedisin dhe kushtet e punës në minierë.
- të dallojë dhe tregojë përdorimet e veglave të punës së dorës së minatorit dhe armatorit.
- të përdorë pajisjet mbrojtëse individuale të minatorit dhe armatorit.
- të dallojë dhe tregojë përdorimet e pajisjeve ngarkuese dhe transportuese në galeri.
- të dallojë dhe tregojë përdorimet e pajisjeve për shpimin e lagur.

- të dallojë dhe tregojë përdorimet e pajisjeve për prodhimin dhe shpërndarjen e ajrit të ngjeshur.
- të dallojë dhe tregojë përdorimet e pajisjeve të kontrollit të mjedisit në minierë.
- të bëjë klasifikimin dhe tregojë përdorimet e materialeve plasëse.
- të bëjë klasifikimin dhe tregojë përdorimet e materialeve për armaturat.
- të tregojë kujdesin e duhur për mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës në miniera (vizita mësimore).
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në minierë fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Atyre duhet ti jepen detyra për mbledhje të informacioneve në lidhje me proceset e punës në minierë. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në minierë.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në miniera.
 - Makete të pajisjeve të punës në miniera.
 - Katalloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Sigurimi teknik në minierë”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	SIGURIMI TEKNIK NË MINIERË	(MK-15-002-14)
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në miniera, si dhe i aftëson ata që ti zbatojnë këto rregulla.	
Kohëzgjatja e modulit	0.5 Kredite 15 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të kenë punuar si ndihmësa në minierë.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan parimet e përgjithshme të sigurimit teknik në minierë. Përmbajtja: - Rëndësia e sigurimit teknik në minierë. - Rreziqet kryesore në minierë, shkaqet e tyre dhe mënyrat e menjanimit. - Rregullorja e teknikës së sigurimit në miniera dhe në karriera. - Dëmet nga moszbatimi i rregullores së sigurimit teknik në miniera. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë rëndësinë e sigurimit teknik në minierë. - të përshkruajë rreziqet kryesore në minierë, shkaqet e tyre dhe mënyrat e menjanimit. - të përshkruajë rregulloren e teknikës së sigurimit në miniera dhe në karriera. - të përshkruajë dëmet nga moszbatimi i rregullores së sigurimit teknik në miniera. RM 2 Kursanti përshkruan masat e sigurimit teknik në minierat nëntoksore. Përmbajtja: - Rreziqet kryesore në minierat nëntokësore dhe shkaqet e tyre. - Rreziqet për rënien nga lartësitë, masat për menjanimin e tyre. - Rreziqet nga gazet shpërthyesë dhe helmuese, masat për menjanimin e tyre. - Rreziqet nga rryma elektrike, masat për menjanimin e tyre. - Rreziqet nga shëmbjet, masat për menjanimin e tyre.	

- Rreziqet nga përmytjet, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga lëndët plasëse, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga zjarri, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga mbilodhja në punë, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga keqpërdorimi i mjeteve të punës, masat për mënjanimin e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë rreziqet kryesore në minierat nëntokësore dhe shkaqet e tyre.
- të përshkruajë rreziqet për rënien nga lartësitë dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga gazet shpërthyes dhe helmuese, si dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga rryma elektrike dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga shëmbjet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga përmytjet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga lëndët plasëse dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga zjarri dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga mbilodhja në punë dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga keqpërdorimi i mjeteve të punës dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të demonstrojë masat dhe veprimet për zbatimin e rregullores së sigurimit teknik në minierat nëntokësore.

RM 3 Kursanti përshkruan masat e sigurimit teknik në minierat sipërfaqësore.

Përmbajtja:

- Rreziqet kryesore në minierat sipërfaqësore dhe shkaqet e tyre.
- Rreziqet për rënien nga lartësitë, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga rryma elektrike, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga shkarkesat atmosferike, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga shëmbjet, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga përmytjet, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga lëndët plasëse, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga zjarri, masat për mënjanimin e tyre.
- Rreziqet nga mbilodhja në punë, masat për mënjanimin e

tyre.

- Rreziqet nga keqpërdorimi i mjeteve të punës, masat për mënjanimin e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rreziqet kryesore në minerat sipërfaqësore dhe shkaqet e tyre.
- të përshkruajë rreziqet për rënien nga lartësitë dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga rryma elektrike dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga shkarkesat atmosferike dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga shëmbjet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga përmytjet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga lëndët plasëse dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga zjarri dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga mbilodhja në punë dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të përshkruajë rreziqet nga keqpërdorimi i mjeteve të punës dhe masat për mënjanimin e tyre.
- të demonstrojë masat dhe veprimet për zbatimin e rregullores së sigurimit teknik në minierat sipërfaqësore.

RM 4 Kursanti përshkruan rregullat për ruajtjen e mjedisit në miniera

Përmbajtja:

- Rëndësia e mbrojtjes së mjedisit në miniera..
- Rreziqet për dëmtimin e mjedisit nga punimet në miniera dhe shkaqet e tyre.
- Rregullorja e mbrojtjes së mjedisit në miniera.
- Masat për mbrojtjen e mjedisit nga punimet në miniera.
- Dëmet nga moszbatimi i rregullores së mbrojtjes së mjedisit në miniera

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të argumentojë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit në miniera.
- të përshkruajë rreziqet për dëmtimin e mjedisit nga punimet në miniera dhe shkaqet e tyre.

- të përshkruajë rregulloren e mbrojtjes së mjedisit në miniera.
- të përshkruajë masat për mbrojtjen e mjedisit nga punimet në miniera.
- të përshkruajë dëmet nga moszbatimi i rregullores së mbrojtjes së mjedisit në miniera.
- të demonstrojë masat dhe veprimet për zbatimin e rregullores së mbrojtjes së mjedisit në miniera.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës në miniera.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore në lidhje me sigurimin teknik në miniera.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për zbatimin e masave të sigurisë në punë në minierë fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Atyre duhet ti jepen detyra për mbledhje të informacioneve në lidhje me sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit në minierë. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë e kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në minierë.
 - Komplet i materialeve dhe mjeteve për të garantuar masat e sigurisë në punë në miniera.
 - Komplete të pajisjeve individuale të minatorit.
 - Rregullore të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në miniera.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Punime përgatitore dhe të kontrollit në galeri”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME PËRGATITORE DHE TË KONTROLLIT NË GALERI	(MK-15-003-14)
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procedurat dhe veçoritë e punimeve përgatitore dhe të kontrollit në galeri, si dhe i aftëson ata që ti kryejnë këto punime në galeritë e minierave.	
Kohëzgjatja e modulit	0.5 Kredite 15 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të kenë punuar si ndihmës në minierë. Të kenë përmbushur modulën MK-15-002-14.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti bën organizimin e vogël për punën në galeri. Përmbajtja: - Kuptimi dhe rëndësia e organizimit të vogël të punës në galeri. - Rolet dhe detyrat e antarëve të grupit të punës në galeri. - Marrja e urdhërit të punës nga eprori dhe analiza e tij. - Ndarja e detyrave. - Marrja e masave për zbatimin e urdhërit të punës. - Sigurimi i mjeteve të punës. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë kuptimin dhe të argumentojë rëndësinë e organizimit të vogël të punës në galeri. - të përshkruajë rolet dhe detyrat e antarëve të grupit të punës në galeri. - të marrë urdhërin e punës nga eprori dhe të analizojë atë. - të kryejë ndarjen e detyrave të punës te antarët e grupit. - të marrë masa për zbatimin e urdhërit të punës. - të sigurojë mjetet e duhura të punës në galeri. RM 2 Kursanti kryen kontrolle në galeri. Përmbajtja: - Kuptimi, rëndësia dhe llojet e kontrolleve në galeri. - Kryerja e kontrollit vizual (pamor) për masat e sigurimit teknik në galeri. - Kryerja e kontrollit të galerisë për copat e varura. - Kontrolli i gjendjes teknike të armaturave në galeri. - Marrja e informacionit për përmbajtjen e gazeve në galeri. - Mbikqyrja e antarëve të grupit gjatë punës në galeri. - Marrja e masave për mënjanimin e parregullsive të	

vërejtura gjatë kontrolleve në galeri.

- Plotësimi i librit të kontrollit të galerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë kuptimin, rëndësinë dhe llojet e kontrolleve në galeri.
- të kryejë kontrollin vizual (pamor) për masat e sigurimit teknik në galeri.
- të kryejë kontrollin e galerisë për copat e varura.
- të kontrollojë gjendjen teknike të armaturave në galeri.
- të marrë informacion për përmbajtjen e gazeve në galeri.
- të mbikqyrë antarët e grupit gjatë punës në galeri.
- të marrë masa për mënjanimin e parregullsive të vërejtura gjatë kontrolleve në galeri.
- të plotësojë librin e kontrollit të galerisë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe veçanërisht në mjediset e punës në galeri.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore si dhe demonstrimet e veprimeve për organizimin e punës dhe kryerjen e kontrolleve në galeri.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për organizimin e vogël të punës dhe për kryerjen e kontrolleve në galeri, fillimisht në mënyrë të mbikqyrtur nga instruktori, dhe më pas në mënyrë të pavarur. Rekomandohet të përdoret metoda e “lojës me role” si dhe diskutimet në grupe në lidhje me detyrat që kryejnë kursantët.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në galeri.
 - Kompleti i materialeve dhe mjeteve për të kryer kontrollet e ndryshme në galeri.
 - Komplete të pajisjeve individuale të minatorit.
 - Modele të urdhërave të punës dhe të librave të kontrollit të galerisë.
 - Katalloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Përdorimi dhe mirëmbajtja e çekiçit shpues pneumatik”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRDORIMI DHE MIRËMBAJTJA E ÇEKIÇIT SHPUES PNEUMATIK	(MK-15-004-14)
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me ndërtimin dhe funksionimin e çekiçit shpues pneumatik, si dhe i aftëson ata për të përdorur dhe mirëmbajtur çekiçin shpues pneumatik.	
Kohëzgjatja e modulit	2 Kredite 60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të kenë punuar si ndihmës në minierë. Të kenë përmbushur modulën MK-15-002-14.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e çekiçit shpues pneumatik. Përmbajtja: - Qëllimi i përdorimit të çekiçit shpues pneumatik në minierë. - Llojet e çekiçeve shpues dhe veçoritë e tyre. - Pjesët kryesore të çekiçit shpues pneumatik me goditje-rrotullim. - Kolona mbajtëse e çekiçit shpues, ndërtimi dhe funksionet e saj. - Kutia shpërndarëse e çekiçit shpues, ndërtimi dhe funksionimi. - Bokulla dhe çekiçi, ndërtimi dhe funksionimi. - Barominat, llojet, ndërtimi dhe përdorimi i tyre. - Kokat e pobieditit, ndërtimi dhe përdorimi i tyre. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë qëllimin e përdorimit të çekiçit shpues pneumatik në minierë. - të tregojë llojet e çekiçeve shpues dhe veçoritë e tyre. - të përshkruajë pjesët kryesore të çekiçit shpues pneumatik me goditje-rrotullim. - të përshkruajë ndërtimin dhe funksionet e kolonave mbajtëse të çekiçit shpues pneumatik. - të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e kutisë shpërndarëse të çekiçit shpues pneumatik. - të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e bokullës dhe çekiçit. - të përshkruajë llojet, ndërtimin dhe përdorimin e	

barominave.

- të përshkruajë ndërtimin dhe përdorimin e kokave të pobieditit.

RM 2 Kursanti përdor çekiçin shpues pneumatik

Përmbajtja:

- Parapërgatitja e çekiçit shpues pneumatik për punë.
- Montimi i çekiçit shpues me rrjetin e ajrit të ngjeshur.
- Montimi i çekiçit shpues me rrjetin e ujit për mënjanimin e pluhurit.
- Përzgjedhja e barominës së duhur për punë.
- Montimi i barominës në çekiçin shpues.
- Montimi çekiçit shpues me kollonën mbajtëse.
- Regjimet e punës gjatë shpimit me çekiç shpues pneumatik
- Teknika e mbajtjes dhe përdorimit të çekiçit shpues, për regjime të ndryshme pune.
- Leximi dhe interpretimi i pasaportave teknike.
- Kryerja e punimeve të shpimit, për regjime të ndryshme, sipas pasaportave teknike.
- Shkëputja e çekiçit pneumatik nga rrjeti i ajrit të ngjeshur dhe i ujit, në përfundim të punës.
- Largimi i pajisjeve të shpimit në përfundim të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës me çekiçin pneumatik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të parapërgatitë çekiçin shpues pneumatik për punë.
- të montojë çekiçin shpues me rrjetin e ajrit të ngjeshur.
- të montojë çekiçin shpues me rrjetin e ujit për mënjanimin e pluhurit.
- të përzgjedhë barominën e duhur për punë.
- të montojë barominën në çekiçin shpues.
- të montojë çekiçin shpues me kollonën mbajtëse.
- të përcaktojë regjimet e punës gjatë shpimit me çekiçin shpues pneumatik
- të demostrojë teknikat e mbajtjes dhe përdorimit të çekiçit shpues, për regjime të ndryshme pune.
- të lexojë dhe interpretojë pasaportat teknike.
